



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. të datës 31.08.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 24.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i strehimores - parkut të qenve" me nr. të prokurimit 616-23-8963-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. të datës 31.08.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 24.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i strehimores - parkut të qenve" me nr. të prokurimit 616-23-8963-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues për të publikuar formularin për korigjimin e gabimeve në njoftimeve të publikuara përmes të cilit do të bëj ndryshim/plotësimin e dosjes së tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim dhe në përputhje të plotë me LPP.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Albi Company" B.I. (tutje "parashtruesi") me datë 31.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 24.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i strehimores - parkut të qenve" me nr. të prokurimit 616-23-8963-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit cituar si në vijim: “Ne si OE Albi Company shpk kemi paraqiture kerkese per sqarime per kerkesen nr 2.4 ku jane kerkuar se paku 10 punetore fizike , ku 2 prej tyre te jeni latue dhe dy prej tyre te jeni armues me perooje pune 3 vite pas diplomimit dhe si deshmi eshte kerkuar qe dorezohen certifikata ose diploma dhe refenca e punes. Ne kerkesen per sqarime kemi argumentuar ne menyre ligjore Certifikatat e tilla per punetore fizike jane te pa lejueshme pasi qe sipas pikes 6.1 te paragrafit 6 te nenit 69 LPP per punet ndertimore pershkruhet qarte se lejohet qe kualifikimet shkollore dhe profesionale qe te kerkohen vetem per personelin udheheqes te OE dhe ne veqanti te personit ose personave qe jane drejteperdrejte eshte ose jane pergjegjes per realizimin e projektit. Sipas pikes 6.4 te paragrafit 6 te nenit 69 LPP per punetoret fizike AK ju lejohet qe te kerkojne vetem raportin per fuqine mesatare punetoreve per secilin nga tri vitet e kaluara. po ashtu neni 8.5 Kriteret e perzgjedhjes te Udhezuesit 001.2023 Tabela ku paraqiten Kriteret e perzgjedhjes qe mund te perdoren nga AK. Ne rast te kontrates per ekzekutim te projekteve punues ose perfaqemances se aktivitetete te ndertimtarise pika a; Minimumi i mesateares se fuqise puneotre dhe stafit menaxherial per secilin nga 3 vitet e fundit , dhe pika d , Deklarata te mesatares se fuqise punetore te OE dhe numrin mesatare te stafit menaxherial per secilin nga 3 vitet Si OE kemi sqaruar se per ta argumentuar se per dy latues, dhe dy armues si deshmi eshte me se e mjaftueshme pervoja e punes se kerkuar. Nuk qendron qe ne si OE jemi duke tenduar qe te ndikojme ne percaktimin e kriterëve, por ne si OE ju kemi argumentuar ne menyre ligjore se certifikatat ose diplomat per punetoret fizike jane te pa lejueshme sipas LPP dhe RRUPP. Ju si AK keni te drejte qe te vendosni kriteret por gjithemon duke u bazuar ne parimet ligjore te lejuar sipas LPP, Rregullores dhe UOPP siq ju percakton paragrafi 2 I nenit 24 LPP. Ndersa sa per informim ne paramase dhe parallogari nuk egziston ndonje pozicion qe nevojite latues pasi qe sipas kuptimit te fjales latues nenkupton lemues se drurit ose lemues se gurit. Ndersa per dy armues punet qe jane parapare te realizohen jane rrytes(katrori 15x15cm) së armaturës së brinjëzuar F6 e cila vjen e gatshme nga fabrikat. Andaj eshte e pa arsyeshme qe kerkohet punetore fizike qe vetem posedojne certifikata apo diploma per nje pune e cila eshte parapare pune te rrethojes per nje mure 0.50 cm me lartesi Kerkese, Kerkojme qe te eliminohet certifikata ose diploma per dy latues dhe dy armues, pasi qe si OE prentendojme se per te argumentuar se mjeshter dijne te realizojne punet jane te mjaftueshme pervoja e punes se kerkuar”.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kerkuar nga njësia kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Me këtë rast njësia kërkuese ka udhëzuar që të bëhen ndryshim/ plotësimet e nevojshme në dosjen e tenderit nëse evidentohet si e nevojshme për të evituar shkeljet potenciale të parimeve themelore të LPP për mos diskriminim/favorizim, ekonomikitet dhe efikasitet.

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit duke marrë parasysh edhe përgjigjet e njësisë kërkuese, ka gjetur se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të bazuara. Kjo për arsye se kërkesat e dosjes së tenderit të cilave ju referohen pretendimet ankimore nuk janë në

përputhje të plotë me paramasën dhe parallogarinë. Rrjedhimisht kërkesat e dosjes së tenderit të cilave ju referohen pretendimet ankimore duhet të riformulohen duke marrë parasysh qëllimin e aktivitetit të prokurimit ashtu që të evitohet çdo mundësi për të vepruar në kundërshtim me parimet themelore të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur retendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.09.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.